




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER  
DREJTORIA E PROJEKTEVE TË INFRASTRUKTURËS

## RELACION TEKNIK

**Objekti :Rijetezimi i kompleksit kulturor “Bylis”, Fier**

### 1. Vendndodhja e objektit

Teatri “Bylis” ndodhet në qëndër të qytetit të Fierit. Ajo kufizohet në lindje me bulevardin “Ramiz Aranitasi”, në veri-perendim me bashkinë Fier, ndersa në jug dhe në lindje me një rrugë lokale.



### 2. Gjëndja ekzistuese

Godina e teatrit "Bylis" është ndërtuar rreth viteve 1967-1971. Projekti fillestar ishte ai i ndërtimit të një kino-teatri. Por në vitin 1975 u rishikua projekti fillestar dhe u ndërtua një shtesë e vashduar në anën lindore dhe veriore të objektit, duke marrë këto forme që e gjejmë sot. Teatri ka një kapacitet prej 434 vendesh. Godina është 3(tre) katëshe, me sistem konstruktiv i kombinuar tra-kollone dhe mure mbajtëse me themele të vazhduara dhe themele të tipit plint. Soletat e ndërkateve janë prej betoni të armuar. Mbulimi i sallës është realizuar me panele të parapergatitura betoni.

Pas ndërtimit të shteses në vitin 1975 investimet për mirëmbajtjen e teatrit kanë qënë të pakta. Përjashtojme rikonstruksionet që janë bërë në nhs-te dhe zëvendesimin e kolltukeve në sallë, nuk ka pasur ndërhyrje në strukturë. Mbulesa ka shfaqur probleme me lagështirën dhe panelet e betonit kanë sfazime nga njëra tjetra.

-Gjatë gjithë sipërfaqes së brendshme të sallës, si dhe të ambjenteve të tjera shtresat niveluese kanë çeduar dhe janë jo të rregullta. Dyshemetë janë të shtruara me pllaka që i përkasin kohës së ndërtimit (pllaka granili, pllaka mermeri me mozaik në holl (fuaje)), të cilat janë të deformuara dhe të dëmtuara. Disa ambjente janë të shtruara me llac-cimento (ambjentet e nënskenes).

-Nën skena është jashtë funksionit dhe nuk funksionon rotativi i skenes.

Shtangetat e mekanizmave janë të dëmtuara dhe nuk janë zëvendësuar asnjëherë që nga kohe e ndërtimit të godines. Gropa e orkestres është jashtë funksionit.

-Muratura perimetrale e objektit shfaq probleme serioze të lagështirës.

-Dritaret janë duralumini me tek xham por shfaqin probleme në termoizolim pasi alumini i përdorur nuk ka spesorin e duhur dhe për pasojë nuk është termik. Një pjesë e dritareve janë të dëmtuara dhe mungojnë xhamat. Dyert e jashtme janë alumini me të njëjtat specifitime si dhe dritaren ndërsa dyert e brendshme janë me kase druri dhe me xham akulli, të cilat janë amortizuar.

-Nr I tualeteve është I pamjaftueshëm. Në katin përde ka 4 tualete (2femra/ 2meshkuj) të cilat nuk mjaftojnë për një sale me kapacitet 434 vende. Ndërsa në anën jugore të objektit, ku ndodhen kabinat e aktoreve ka 2 tualete pothuaj jashtë funksionit.

-Shkallët e brendshme janë me bazamak granili, pjesërisht të thyer, dhe me parapet hekuri me korimano druri.


-Objekti është e mbuluar me solete, e cila paraqet probleme serioze të lagështirës. Vëmë re dëmtime dhe në disa raste edhe mungesë të ulluket vertikale dhe horizontale.

Me vëzhgimin e gjëndjes në vend të teatrit evidentohen shumë probleme serioze për zhvillimin normal të aktivitetit artistik.

Foto të gjëndjes ekzistuese:







### 3. Objektivat e Projektit

Nepermjet ketij projekti synohet krijimi i nje poli kulturor bashkekohor ne qytetit e Fierit, me fokus ne stimulimin e kreativitetit dhe te artit. Ky objekt do te sherbeje si nje qender arti me standarte europiane.

#### **Funksioni i objektit**

Sipërfaqja e sheshit të ndërtimit shtrihet në pronë shtetërore, në një sipërfaqe prej 2706m<sup>2</sup>. Sipërfaqja e ndërtimit në katin përfaqësohet me 1673 m<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja totale e ndërtimit është 4179 m<sup>2</sup>, nga të cilat 473 m<sup>2</sup> zhvillohen pjesërisht nëntokë.

Objekti kufizohet nga të katërta anët me rrugë dhe ka hyrje në secilin prej tyre. Hyrja kryesore (nga fasada lindore) është rrethuar. Duke qenë se hollit kryesor është shtuar në sipërfaqe (nga 164 m<sup>2</sup> në 334m<sup>2</sup>) janë rikonceptuar funksionet si recepsion, garderober dhe hapësira ekspozitive. Hollit kryesor do të vishet me MDF me ngjyra të ndryshme sipas projektit.

Tualetet janë rikonceptuar duke u shtuar në numër si dhe duke ndërtuar dhe nhs për PAK. Ambjenti I biletarise do të spostohet. Hyrjet për në salla vashdojnë të jenë të njëjtat por tashmë salla do të shtrohet e gjitha me parkete laminat. Pjesa e skenës do të vishet me parket druri cilesia e parë. Veshja e mureve të sallës si dhe tavani i sallës do të ruhen duke bërë riparime e nevojshme pasi nga provat e kryera në salla është konsistuar që akustika është e mirë. Për të evituar demtime të saj nuk do të ndryshojmë morfologjinë e sallës. Në salla do të rikthehet ambjenti i llozës në fund të saj. Të gjitha ambjentet e shërbimit pas skenës si kabinat e aktoreve, nhs për stafin, depo e materialeve skenike, do të rikonstruktohen totalisht. Ambjenti I nhs-se krahas zyres së drejtorit do të ndahet në dy ambjente, përkatësisht nhs dhe kuzhinë. Kjo e fundit do shërbejë për stafin.

Në katin e parë teknik do të nderhyet vetëm në ambjentet e dy nyjeve sanitare. Në katin e dytë teknik do të krijohen ambjente teknike për foninë dhe ndricimin. Në këto ambjente do të zgjerohen dritaret që shikojnë nga skena për të rritur cilësinë e komunikimit të teknikeve përkatës me skenën.

Në katin nëntokë janë ruajtur hapësirat ekzistuese do të krijohet ambjent teknik për vendosjen e depozitave të ujit si dhe për elektrikun.

#### **4. Arkitektura, Fasada dhe Rifinitura**

Gjithë fasada e objektit nuk do të pësojë ndryshime me përjashtim të zonës së hollit, ku do të kemi spostim të vetratave në nivelin e rreshtit me perimetral të kullonave. Veshja me gur në katin përfaqësohet do të ruhet, do të trajtohet me ujë me rërë me presion për të realizuar pastrimin e tij të plotë.

#### **5. Zgjidhja teknike e problematikave**

Duke u bazuar në gjëndjen ekzistuese të objektit të konstatuar nga inspektimi i kryer në terren, për realizimin e objektivave të projektit janë parashikuar punime sipas zërave të mëposhtëm:

##### **1-Rikonstruksioni i ndërtimit 3+1-kateve**

**-Në katin e përfaqësohet** do të zhvillohen këto ambjente;

-Salla e teatrit, skena, paraskena;

-Hollit kryesor, rikonceptimi I tij në dimensione, veshje dhe funksionim;

-Recepsioni+garderober

-Nhs/publiku do të rikonstruktohen totalisht dhe do të ndërtohen nhs për PAK

-3 Kabina aktori

-Nhs/stafi do të rikonstruktohen totalisht;

-Depo për materialet skenike;

-Depo dekorësh (Shtesë e realizuar në anën perëndimore)

-Zyra e drejtorit

-Nhs

-Kuzhinë

-Zyra e regjisorit

-Biletaria

-Ambjent sherbimi+nhs+depo  
-Ambjent teknik  
-Ambjent teknik elektrik  
-Magazine

**-Ne katin e pare** do te zhvillohen keto hapsira;  
- Dy Nhs/stafi do te rikonstruktohen totalisht;  
-Llozha ( do te kthehet funksionale)

**-Ne katin e dyte** do te zhvillohen keto hapsira;  
-Ambjent teknik ndricimi  
-Ambjent teknik fonia

**Punimet qe do te zbatohen per rikonstrukcion jane si me poshte:**

- Zevendesimi i shtresave te gjitha ambjenteve me pllaka porcelanat importi cilesia e pare
- Holli kryesor aktualisht eshte i shtruar me pllaka granili, do te behet paketa e plote e shtresave dhe do te vishet me pllaka mermeri
- Shkallet qe te cojne ne katin e fundit, aktualisht prej druri do te realizohen me kons metalik.
- Nhs ne krah te zyres se drejtorit do te ndahet ne dy ambjente, perkatesisht nhs dhe kuzhine
- Holli kryesor do te vishet me MDF me ngjyra te ndryshme sipas projektit
- Nhs ne hollin kryesor dhe ne ambjentet e kabinave te aktoreve jane shtuar ne numer, Ndarjet midis tualeteve jane realizuar me melamine te plastifikuar. Ne hollin kryesor jane shtuar dy tualete per PAK.
- Holli kryesor ne katin perdhe do te rritet ne siperfaqe duke spostuar vijen perimetrale te vetrates ekzistuese te xhamit.
- Muri ekzistues me veshje guri ne hollin kryesor do te trajtohet me uje me rere me presion per te realizuar pastrimin e tij te plote.
- Te gjitha ambjentet e brendshme do te suvatohen dhe do te lyhen me boje hidroplastike cilesia e pare .
- Dyert ekzistuese jane zevendesuar me dyer importi cilesia e pare, ndersa dyert e tualeteve jane duralumini me mbushje
- Vetratat jane duralumini me dopio xham transparent (4+4) i laminuar + 16 mm hapesire me argon + 4+4 i laminuar dhe pjeserisht me filter gjysme transparent.
- Skena eshte shtruar me parket druri ndersa shkallaret e salles jane veshur me rezine. Te gjitha shkallaret e salles si dhe koridoret levizese jane shtruar me moket.
- Ambjentet teknike te fonise dhe ndricimit jane zhvendosur ne katin e fundit ndersa ambjenti ekzistues i tyre eshte kthyer ne llozhe.
- Sistemi hidraulik per funizim-shkarkimin e ujrave eshte realizuar nga e para.

Punoi:

Ark. Alba Çako

Ing. Ndert. Mariola Velaj